



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 4672 prot.

Pogradec, më 14, 11, 2023

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Zj. Manjola Kamolli**  
**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuara zonja Kryetare,**  
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për miratimin e titullit të nderit “QYTETAR NDERI”

Me respekt,

**KRYETARI**

**Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 ( dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 ( dy)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Pogradec, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**PËR MIRATIMIN E TITULLIT  
“ QYTETAR NDERI”**

**FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)**

Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023, me propozim të një grup qytetarë pogradecarë dhe Shoqata “Antikomuniste e ish të Përndjekurve Politikë” Dega Pogradec, me aprovim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec dhe me miratim nga Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54 germa “m” e tij, ligjit nr. 112/2013 “Për Dekoratat, Titujt e Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “ Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve Këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujve Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullores së Bashkisë Pogradec “Për llojet e Titujve te Nderit, Kriteret dhe Proceduren e dhënies së tyre” Neni 5.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

- 1- Miratimin e dhënies së titullit të nderit “ QYTETAR NDERI”

**FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)**

Me motivacion: **Figurë frymëzuese në dashurinë për liri dhe atdhedashuri. Për kontributet e shquara si humanitar duke ndihmuar familjet në vështirësi ,mbështetës për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Pogradecit.**



2- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënien e Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pogradec.

**K R Y E T A R**

**MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Pogradec, më \_\_, \_\_, 2023

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin për miratimin e titullit të nderit “ QYTETAR NDERI” për **FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)**

I nderuar Kryetar i Këshillit!  
Të nderuar Këshilltarë!

Propozimi i mësipërme për dhënien e titullit të nderit “ QYTETAR NDERI” për **FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)** bëhet në respekt të figurës dhe kontributeve të tij në qytetin e Pogradecit.

Projekt vendimi që po ju paraqesim është rrjedhojë e detyrimit ligjor që ka Institucioni i Bashkisë Pogradec, për të bërë të mundur dhënien për miratimin e titullit të nderit “ QYTETAR NDERI” , por dhe detyrimi shpirtëror ndaj figurës së tij e cila është përshkruar hollësisht në jetëshkrimin e Feridon Fezollarit.

Kërkojmë nga ana e Këshillit Bashkiak të akordojë titullin “ QYTETAR NDERI” për:

**FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)**

Me motivacion: **Figurë frymëzuese në dashurinë për liri dhe atdhedashuri. Për kontributet e shquara si humanitar duke ndihmuar familjet në vështirësi, mbështetës për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Pogradecit.**

**Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.**

**Faleminderit!**



**Konceptoi:** Juriste

Eljana Blacëri

**Pranoi:** Kryetare e Komisionit Këshillimor  
Për dhënie të titujve të nderit

Entela Gusho

**Miratoi:** SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Dritan Babasuli

**Konfirmoi:** KRYETAR

Ilir Xhakolli



## CV FERIDON HAKI FEZOLLARI

Feridon Haki Fezollari ka lindur në 29.03.1940 ne Pogradec në një familje me ndjenja të theksuara patriotike, të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në mbrojtjen e idealeve të lirisë , atdheut dhe Pogradecit.

Babai i tij Haki Fezollari ka qënë luftëtar , patriot dhe liridashës duke transmetuar edhe tek fëmijët këto vlera atdhedashuri. Mbas çlirimit të Shqipërisë me vendosjen e komunizmit dhe diktaturës Haki Fezollari nuk mund të duronte regjimin socialisdhe persekucionin ndaj u arratis nga Shqipëria në vitin 1949 , mbasi ishte arestuar disa herë dhe kishte shpëtuar pushkatimit.

Feridoni , djali më i madh i Familjes ishte vetëm 9 –vjet kur u internuan familjarisht së bashku me nënën e tij Kushe në Kamëz të Tiranës duke përjetuar tmerret e vujatjeve të internimit dhe persekutimit politik deri në vitin 1954

Pas kthimit në Pogradec, nënë Kushen e kishin lënë në mes të skamjes me katër fëmijët e vegjël dhe nën peshën e përndjekjes. Ndonjëse 14 vjet Feridoni fillon të punojë fort për të mbajtur familjen por dhe studion njëkohësisht duke dalë me rezultate të shkëlqyera në shkollë. Por fati i tij ishte i destinuar të mos ndiqte arsimin më lartë për arsye politike.

Në vitet 1960 ,situata politike në Shqipëri po rëndohej. Ndërprerja e mardhëdhënieve me Bashkimin Sovjetik bëri që ATA që kishin biografinë e keqe të përndiqeshin dhe persekutoheshin edhe më fort duke bërë të padurueshme jetën. Feridoni asnjë cast nuk u përkul , vazhdonte të punonte fort por dhe të mendonte se si mund të largohej nga ky kalvar i tmerrshëm, të aratisej larg Shqipërisë dhe të shkonte pranë babait të tij në Australi.

Për motive politike arestohet në vitin 1961 kur ishte vetëm 21 vjet.Gjykata e dënon me burg për 13 vjet dhe vuan heqjen e të drejtës së lirisë në burgjeët e Vlorës, Fierit dhe Spac.

Lirohet në vitin 1971 dhe fillon punë në Ndermarrje të ndryshme të Pogradecit ku do të dallohet për punën e palodhur dhe i dashur me shokët.

Feridoni dallohet për nje inteligjencë të lartëe dhe shumë i sukseshëm në punën që ai kryente. Në Ndërmarrjen e Përpunim Drurit do të ishte nga novatorët kryesorë të kësaj Ndërmarrje ku do të shquhej për përshtatjet e mjeteve të punës në ndihmë dhe lehtësimin e punëve të rënda fizike duke lehtësuar lëvizjet , transportin e trupave të drurit apo dhe përpunimit të tyre. Ndonjëse ishte vetë Ai që krijonte këto novatorizma emri i tij nuk do të përmëndeje kurrë.



Duke përjetuar cdo cast përndjekjen , persekucionin dhe distancimin e shokëve dhe miqve kalonin vitet por Feridoni nuk mund të përshtatej sistemit komunist-socialit të vendit të tij.

Qysh prej vitit 1961 ai kishte menduar të arratisej nga Shqipëria tani që ishte familjar dhe rreth tij kishte fëmijët , vëllezërit dhe motrën e shihte si domosdoshmëri ikjen dhe bashkimin me babanë e tij. Filloi intesivisht të mendonte se si mund të aratisen të gjithë duke ideuar varkën , atë shpëtimtaren e vetme.

Mbas shumë përpjekjesh dhe provash kjo ikje aq e dëshiruar ndër vite realizohet në 3 korrik 1975. E gjithë familja e Haki Fezollarit me varkë kalojnë liqenin dhe aratisen për në Jugosllavi nga Shën Naumi ndërsa diktatori pushonte në Pogradec.

Në letrën e tij të fundit të ikjes lënë në shtëpinë e tij u shkuajt:

“Nuk po tradhëtoj Atdheun por regjimin dhe sistemin tuaj”

Imagjioni vetëm për një moment një natë të errët buzë liqenit ku ju dhe familja juaj po prisni të ngjiteni në një varkë primitive të bërë me mushama, një udhëtim që do të zgjasë për orë të tëra deri në bregun tjetër...kthim pas nuk ka! Në varkë bashkë me burrat, gratë e fëmijët gjendet dhe një kuti me dinamit me fitilin gati për t’i vënë shkrepësen, për t’u bërë shkrumb e hi nëse rojet e kufirit ju pikasin. Jeni ju, fëmijët që flenë, frika në stomakun tuaj që rëndon më shumë se rrobat e lagura, hëna e fshehur pas një reje të zezë dhe jeta e varur mbi një fije shprese.

Me pak fjalë ky është peizazhi që mund të përshkruhet ajo natë e 3 korrikut në të gdhirë 4 korriku i vitit 1975 në liqenin e Pogradecit...këto ishin orët e gjata drejt lirisë, udhëtimi i patëdytë i familjes Fezollari. Ata kishin vënë bast me vdekjen. Për ta jeta nuk ishte më asgjë pa lirinë, ndaj ndërmorën këtë udhëtim, këtë arratisje, që do të merrte epitete nga më të ndryshmet në vazhdimësi, e denjë për një film për ‘Oscar’ sigurisht.

Vitet e qëndrimit në Australi ishin shumë intensive për Familjen Fezollari. Ata integrohen si në punë dhe shoqëri duke qënë shëmbull të sjelljes në komunitet. Falë këmbënguljes së tyre ngrejnë Kompaninë duke punësuar 100 punëtorë. Ndonjëse të sukseshëm dhe plot energji Feridoni nuk e harroi kurrë Shqipërinë kishte mall për gjithë njerëzit e dashur për pogradecarët.

Gjatë fundit të viteve ’80 në Europë kanë filluar lëvizjet anti komuniste dhe shkërmoqja e kampit socialist. Familja Fezollari e sidomos Feridoni mezi po presin përmbysjen e madhe edhe në Shqipëri. Pret që edhe Shqipëria të clirohet nga komunistët.



Ishin vitet 1991-1992 që Feridoni të kthehej në Shqipëri së bashku me familjen e tij si dikur por tashmë të rritur dhe familjarë .

Nuk kishte kohe për të humbur duhet të fillonin të punonin por dhe të ndihmonin jo vetëm të afërmit e tyre të cilët kishin vuajtur dhe ishin persekutuar nga regjimi komunist por të ndihmonin edhe njerëzit në nevojë. Feridoni nuk kishte ardhur si kapitalist nga Australia por dhe si bamirës. Në fillim hap një lokal me emrin “Fortesa” për të kujtuar ikjen e madhe pranë fortesës. Lokali ishte dhe restorant dhe punonte në kosto. I gjithë farefisi hante dhe pinte falas dhe Birra me Cocacola qeraseshin pa lekë.

Energjia dhe këmbëngulja për të punuar vazhdonte të spikate tek Feridoni , në vitin 1993 pranë Pallatit të Kulturës në Pogradec hapet Disco “Diamond” e para në qytetin tonë ku do të organizoheshin krahas festa për të rinjtë edhe aktivitete kulturore , promovime libri etje.

Gjithashtu do të çelen Firma biznesi për import produktesh të ndryshme , kompani elektronike , duhan cigare etje.

Paralelisht Feridoni do të ishte inisiatori i shumë ndihmave të familjeve në nevojë duke lehtësuar vështirësitë ekonomike të tyre. Në çdo festë Bajrami apo fund viti do të ndihmoheshin afro 200 familje me pako ushqimore për të gezuar në këto ditë festive.

Në ditët e vështira të vitit 1997 do të ishte organizatori kryesor për ngritjen e grupit të Emergjencës për furnizimin e qytetit me produkte ushqimore e sidomos në mbrojtje të institucioneve të rëndësishme të cilat rrezikoheshin të shkatëroheshin plotësisht.

Qyteti ku Feridoni u lind dhe u rrit kishte nevojë edhe për një institucion mediatik ndaj u propozua të ngrihej nje television lokal. Djemte e tij Bajrami dhe Lirimi dëshironin të çelej në Tiranë. Feridoni këmbënguli që Televizioni do të hapej në Pogradec dhe kështu në vitin 1998 lindi SOT7.

Të gjithë punonjësit e SOT7 do ta kujtojnë me shumë dashuri Feridonin për ndihmën dhe idetë e tij në punën e përditshme.

Ndron jetë papritur në vitin 2002 duke lënë përgjithmonë emrin e tij si simbol të lirisë, atdhedashurisë , i punës së palodhur dhe humanist.

Vepra dhe lufta e tij për liri është shkruar edhe në “Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist” – VËLLIMI II



Këshilli i Bashkisë Tiranë me Vendim nr 3 datë 26.1.2016 , Emerton një nga rrugët me emrin  
“Feridon Fezollari”



Për 25 vjetorin e Televizionit SOT7 , Kryetari i Bashkisë Z. Ilir Xhakolli i akordoi familjes dhe Z. Feridon Fezollari Certifikatën e Mirënjohjes (Pas vdekjes) me motivacion “Për kontributin e dhënë në ngritjen dhe konsolidimin e Televizionit “SOT 7”. Ndihma dhe këshillat e tij të vyera, mbetën themele të forta, në ecjen përpara të këtij institucioni mediatik, privat në Pogradec”.

Për gjithë veprimtarinë e tij propozohet që z.Feridon Fezollari ti jepet titulli “Qytetar Nderi” i Pogradecit.

## PROCES- VERBAL

I mbajtur sot në datën 08.11-2023 në Bashkinë Pogradec në lidhje me mbledhjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit i përbërë nga :

- Entela Gusho Kryetar
- Eritan Kamolli Anëtar
- Froselda Tola Anëtar
- Anastas Kostandini Anëtar
- Vilson Mako Anëtar

Mbledhja e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit u zhvillua në Sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ora 10.30.

Komisioni i cili është i aprovuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 8 datë 28.01.2020 , diskutoi rreth kërkesës e ardhur nga Këshilli Bashkiak nr 3860/2 datë 16.10.2023.

lidhur me kërkesën e një grup prej 210 qytetarësh pogradecare dhe Shoqata “Antikomuniste e ish të përndjekurve politikë” , Dega Pogradec ,për akordim titullin “Qytetar Nderi” për Feridon Fezollari (Pas vdekjes).

Komisioni duke u mbështetur në Rregulloren “ Për llojet e titujve të nderit , kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre” si detyrim ligjor që ka Institucioni i Bashkisë Pogradec, për të bërë të mundur dhënien e Titujve Vendorë të Nderit për personalitetet dhe figurat e shquara të Bashkisë Pogradec, të vendit dhe të huaj me kontribute të vecanta morri në shqyrtim kërkesën. Kërkesa e mësipërme mbasi u diskutua nga Komisioni u propozua që Feridon Fezollari ti jepet titulli i nderit “Qytetar Nderi” ( Pas vdekjes).

Mbas votimit Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve të Nderit vendosi që :

1. Ti propozojë Këshillit të Bashkisë Pogradec : Miratimin e dhënies së titullit të nderit
2. Miratimin e dhënies së titullit të nderit “ QYTETAR NDERI”

### FERIDON FEZOLLARI ( PAS VDEKJES)

Me motivacion: **Figurë frymëzuese në dashurinë për liri dhe atdhedashuri. Për kontributet e shquara si humanitar duke ndihmuar familjet në vështirësi ,mbështetës për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Pogradecit.**

U la detyrë të hartohet relacioni dhe projekt –vendimi përkatës.

Mbledhja përfundoi ora 11.00

Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit

- Entela Gusho Kryetar 
- Eritan Kamolli Anëtar 
- Froselda Tola Anëtar 
- Anastas Kostandini Anëtar 
- Vilson Mako Anëtar 